



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, 27.7.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Igor Simiq, kryetar, Danush Ademi, nënkryetar i dytë, Rasim Selmanaj, Mufera Serbica- Shinik, Zoran Mojsilović, Albert Kinolli, Slobodan Petrović dhe Veton Berisha, anëtarë.

**Munguan:** Xhelal Sveçla, Fadil Beka, Kujtim Shala, Haxhi Shala, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević dhe Duda Balje, anëtarë

Pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues i OSBE-së Senad Karaahmetovic; përfaqësues nga KDI-ja- Gresa Maxhuni, gazetar të KTV Xhengis Maqenonsi dhe Ridvan Hamza; gazetar nga Ekonimaonline-Valbona Bytyqi; gazetar të Radio Kosova - Kosovare Gashi; këshilltar i Sekretariatit të KKK-së Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Natasa Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Igor Simiq, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportimi i ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, z. Bejtush Gashi, me temën: Shpallja e konkursit policor të Kosovës dhe përfaqësimi i komuniteteve.**
- 3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 20.6.2018;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-058 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe amendamenteve të Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.*

**Kryetar**, hapi mbledhjen e komisionit dhe fillimisht përshëndeti pjesëmarrjen e ministrit, z. Bejtush Gashi dhe kolonelës së Policisë së Kosovës, znj. Taibe Canolli- Brajshori.

Theksoi se anëtarët e komisionit kanë paraqitur interesim, që të informohen për procedurat e shpalljes së konkursit policor, kushtet për aplikimin e përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë, si dhe të dhënat statistikore.

Ministri i Punëve të Brendshme, **Bejtush Gashi**, raportoi para komisionit lidhur me kushtet e shpalljes së konkursit të Policisë së Kosovës dhe përfaqësimin e komuniteteve. Në fillim, ministri Gashi tha se Policia e Kosovës është në shërbim të të gjithë qytetarëve, të cilët jetojnë në Kosovë, pa dallim etniteti, gjinie, ngjyre, religjioni dhe orientimi seksual.

Duke folur për shpalljen e konkursit nga ana e Policisë së Kosovës dhe përfaqësimi i komuniteteve, ministri Gashi tha se ky konkurs ka qenë i hapur prej datës 16.4.2018 deri më 10.5.2018 dhe kanë aplikuar më shumë se 17.620 kandidatë. Nga ky numër, 15.162 kandidatë janë të gjinisë mashkullore dhe 2.358 të gjinisë femërore. Në fazën e parë, kandidatët duhet të kalojnë pragun e 70%, në mënyrë që të marrin pjesë në fazën e dytë të testit, ndonëse deri më sot nuk është kryer verifikimi dhe sistematizimi i kandidatëve.

Në konkursin e shpallur për zyrtarë policorë, zbatohet vendimi i datës 26.3.2018, me numër të referencës 01/0188, për zbatimin e masave të veçanta të përkohshme afirmative. Këto masa të veçanta do të zbatohen për inkurajimin e gjinisë femërore.

Polica, në bashkëpunim me OSBE-në, ka organizuar fushatë informuese në drejtoritë rajonale. Fokusi i fushatës ka qenë rekrutimi nga radha e komuniteteve, *siç janë*: komuniteti rom, ashkali, egjiptian, serb dhe komuniteteve tjera. Disa të rinj, për pozita të zyrtarëve, hezitojnë të konkurrojnë, siç është rasti në lagjen e romëve në veri të Mitrovicës, Vushtrri, Skenderaj, Klinë, Dragash dhe komuna tjera.

Ministri Gashi, prezantoi raportin me të dhëna statistikore të regjistrimit për vitin 2011 si vijon: në polici, pjesëmarrja e komunitetit shqiptar ka qenë 92.93% , ndërsa nga radha e etniteteve që jetojnë në Kosovë ka qenë 83.64%.

Në bazë të statistikave, numri i aplikuesve në konkursin policor të Kosovës për vitin 2018 është: pjesëmarrja e komunitetit shqiptar është 16,263, përqindja 92,30 %; komuniteti serb 1.47%, pjesëmarrja etnike 11.92%, pjesëmarrja e aplikuesve 865, përqindja 4,9%; komuniteti turk 1,08%, pjesëmarrja etnike 0,88%, pjesëmarrja e aplikuesve 101, përqindja 0.57%; komuniteti boshnjak 1,58%, pjesëmarrja etnike 2,43%, aplikues 196, përqindja 1,11%; komuniteti rom, pjesëmarrja etnike 0,51%, aplikues 0.18%, përqindja 0.19%; komuniteti ashkali, 0.89%, pjesëmarrja etnike 0.22%, aplikues 64, përqindja 0.36%; komuniteti egjiptian, 0,66%, pjesëmarrja etnike 0.09%, aplikues 58, përqindja 0,33%; komuniteti goran, 0.59%, pjesëmarrja etnike 0.46%, aplikues 27, përqindja 0.15%; dhe, Pjesëmarrës tjerë 0.14%, pjesëmarrja etnike 0.17%, aplikues 12, përqindja totale 0.07%.

**Në vazhdim të ekspozesë** , ministri u shpreh se pas shpalljes së konkursit, drejtori i Departamentit për Burime Njerëzore, ka formuar Komisionin përzgjedhës për kadetë, në përputhje me udhëzimin administrativ në fuqi. Ky komision është përgjegjës për mbikëqyrjen e tërë procesit të rekrutimit, të selektimit, menaxhimit, shqyrtimit, si dhe vlerësimit e aplikacioneve të dorëzuara për punësim, dhe në fund, për dhënien e përgjigjeve të ankesave të kandidatëve.

Komisioni përgjegjës është në fazën përfundimtare të shqyrtimit të aplikacioneve, siç janë: regjistrimi i të dhënave dhe përgatitja e listave meritore të kandidatëve, të cilët ftohen në testin me shkrim dhe të atyre që diskualifikohen.

Ky proces do të jetë shumë transparent dhe vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e parapara me konkursin e shpallur dhe kalojnë testin me sukses, do të jenë pjesëtarë të Policisë së Kosovës. Kandidatët, të cilët duhet t'i plotësojnë kriteret e konkursit të shpallur, iu nënshtrohen këtyre procedurave: testit me shkrim, testit të aftësisë fizike, intervistës me gojë, testit psikologjik, kontrollimit mjekësor, dhe në fund, verifikimi i së kaluarës.

**Veton Berisha**, falënderoi për pjesëmarrjen në takim të ministrit z. Gashi dhe togeres znj. Taibe, dhe dhënien e informatave pozitive që kanë një rëndësi të veçantë për ne.

Në muajin prill të këtij viti, ka iniciuar çështjen e shpalljes së konkursit publik, pasi në këtë konkurs nuk kanë qenë të përfshirë komuniteti egjiptian dhe ashkali. Pas këtij reagimi, është arritur bashkëpunim i mirëfilltë me Ministrinë për Punë të Brendshme, dhe në ditën tjetër është evituar gabimi teknik, për çka edhe jam shumë mirënjohës.

Zhvillimet e sistemit policor janë të rëndësishme së veçantë edhe për komunitetin që unë përfaqësoj. Në bazë të statistikave zyrtare që ka, në Shërbimin Policor të Kosovës janë të inkuadruar vetëm 7 pjesëtarë të komunitetit egjiptian dhe ky fakt nuk më bën të ndihem mirë.

Po ashtu, parashtrori pyetje për ministrin: Cilat janë planet e parapara të ministrisë lidhur me shpalljen e konkursit të policisë, për këtë vit, në emër të komuniteteve joshumicë?

Cilat janë kriteret e gradimit të zyrtarëve të komunitetit joshumicë? Ju them me bindje të plotë se në të kaluarën nuk është graduar asnjë policë i komunitetit egjiptian, edhe për kundër vullnetit të mirë që të bëhen pjesë e barabartë me qytetarët tjerë që jetojnë në Kosovë.

Ministri **Gashi**, u shpreh se kushti kryesor është arritja e kuotës prej 70%, në të kundërtën nuk merren parasysh kandidatët, të cilët nuk kalojnë këtë prag.

Për ne, është me rëndësi të respektohet standardi i uniformës, përfaqësimi shumetnik, i cili drejtpërdrejt ndikon në rritjen e besueshmërisë. Sa i përket procesit të gradimit, bëhet mbikëqyrja në baza profesionale të zyrtarëve, që duhet plotësuar standardet e përcaktuara me ligj.

Gjithnjë bëjmë përpjekje, që përmes përgatitjeve shtesë, të inkurajohen komunitetet tjera dhe të bëhen pjesë e këtij procesi.

Përgjegjëse për procedurat e këtij procesi është kolonelja znj. Taibe, e cila do t'iu ofrojë informata më në detaje.

**Taibe Canolli- Brajshori, kolonele në Policinë e Kosovës**, tha se Policia e Kosovës ka krijuar një standard të avancuar për punësim, mundësi të barabarta, që garanton gjithëpërfshirje, bazuar në praktikën ndërkombëtare dhe gjithmonë duke u bazuar në respektimin e Ligjit të Policisë. Në kuadër të akteve nënligjore dhe udhëzimeve administrative, janë caktuar në mënyrë të detajuar standardet operative, procedurat e aplikimit, rekrutimit dhe të selektimit të kandidatëve.

Sa i përket çështjes së punësimit, kemi të bëjmë me zbatimin e masave të përkohshme afirmative. Si prioritet ka gjinia femërore, gjithmonë duke pasur parasysh kalimin e kuotës 70%. E them këtë me qëllimin më të mirë, ngase është e nevojshme të rritet përqindja prej 14%, me qëllim që gjinia femërore të bëhet pjesë e uniformës në Kosovë.

Kriteret e gradimit janë: përvoja e punës, vlerësimi i performancës, përgatitja arsimore, si dhe kalimi i të gjitha testeve. Ne gjithnjë bëjmë përpjekje, që përmes përgatitjeve shtesë, t'i inkurajojmë edhe komunitetet tjera që të jenë pjesë e këtij procesi.

**Mufeta Serbica- Shinik**, falënderoi ministrin për raportim e mirëfilltë lidhur me kushtet e shpalljes së konkursit të policisë.

Si shembull morri rastin, një familjen e cila jeton në Prizren, babai me dy djemtë janë të punësuar në shërbimin policorë, njëri është paraqit nga radha e komunitetit shqiptar, i dyti nga radha e komunitetit turk dhe i treti boshnjak. U ndërlihdh me rastin, nëse babai përfaqëson komunitetin shqiptar ndërsa nëna komunitetin boshnjak, atëherë djali nuk mundet ti përket komunitetit turk.

Në kuadër të këtij kontesti, ne, nuk jemi kompetent të bëjmë verifikimin e prejardhjes së tyre kombëtare. Për zgjidhjen e kësaj çështje, ishte e mendimit që kandidatët, së pari, të nxjerrin dokumentin e verifikimit në Agjencionin për Regjistrim Civil.

Sa i përket shpalljes së konkursit, MASHT-i, i ka publikuar testet me shkrim në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Këto janë arsyet pse kandidatët e komunitetit turk, nuk arrijnë ti plotësojnë aplikacionet, në bazë të kuotës së përcaktuar me ligj.

Ajo dha propozim konkret, që në të ardhmen, testet me shkrim të publikohen edhe në gjuhën turke.

**Danush Ademi**, kërkoi që të informohet lidhur me përqindjen e saktë të pjesëtarëve të komunitetit rom në sistemin policor të Kosovës.

Më tej, theksoi se në çdo konkurs të shpallur policor, aplikojnë përfaqësuesit e komunitetit ashkali, por atyre nuk u mundësohet klasifikimi në shërbimin policor. Në afatin e kaluar, kandidatët e komunitetit ashkali kanë kaluar pragun e kalueshmërisë, janë pranuar në shërbimin policor, mirëpo të njëjtin kanë mbetur në pozitën rezervë.

Ai propozoi që përqindjen prej 22%, në emër të komuniteteve, të jetë e barabartë për të gjitha komunitetet. Kjo e drejtë garantohet me Ligjin për shërbimin civil, ku përcaktohet kuota prej 10% për punësimin e komuniteteve.

Më tutje, tha se mbi 10 vjet nuk është graduar asnjë policë nga radha e komunitetit ashkali. Andaj, kërkoi që të bëhet gradimi i të njëjtëve, me qëllim që të kenë motivim gjeneratat e reja. Në fund, shtoi se asnjë polic i komunitetit ashkali nuk është inkuadruar në komunikacionin rrugor, përveç një polic në uniformë, i cili me vite shërben në ruajtjen e kishës në Ferizaj.

Kjo situatë paraqet shqetësim për ne, andaj kërkujmë që të gjendet një zgjidhje e përhershme për këtë komunitet.

**Kryetari**, pajtohet që të respektohet Ligji për Policinë, me qëllim që kandidatët të përmbushin kushtin e kuotës prej 70% dhe të inkuadrohen në Shërbimin Policor të Kosovës. Mirëpo, si kërkesë e tij ishte që të respektohet edhe Ligji për punë, neni 11, gjithnjë duke marrë për bazë 10% për punësimin e komuniteteve.

Kur bëhet fjalë lidhur me rritjen e kapaciteteve në polici, shtrohet pyetja se cilat janë planet e ministrisë për t'i mundësuar punësimin komunitetit serb në Shërbimin Policor të Kosovës. Posaçërisht, është i interesuar të dijë lidhur me pozitën e të kthyerve, të cilët jetojnë në Klinë, Istog, Pejë, Lipjan, duke konstatuar se para disa muajve ka pasur aksident etnik, me disa pjesëtarë të komunitetit serb dhe nuk janë ndërmarr veprime adekuate.

Më tej, u ndërlihdh me temën në fjalë, duke konstatuar se ministria duhet të përcaktojë prioritetet për implementimin e strategjisë për punësimin në këto rajone, në mënyrë që komunitetit serb të ketë besueshmëri dhe vullnet të mirë që të jetojë dhe të veprojë në Kosovë.

**Albert Kinolli**, është mirënjohës për dhënien e informatave të ministrit dhe bashkëpunëtores së tij, lidhur me sistemin policor dhe situatën në terren. Ai ceku se entuziazmi i juaj ministër, për zhvillimet e këtyre proceseve, më bën të ndihem mirë.

Mirëpo, disa çështje janë dekurajuese për komunitetin rom. Ekziston fakti se në emër të këtij komuniteti janë punësuar pjesëtarë tjerë, të cilët deklarohen se i takojnë këtij komuniteti.

Po ashtu, konsideroi se në të ardhmen nuk duhet të përsëritet ky proces. Nëse ka vullnet të evitohet ky problem, djemtë dhe vajzat tona do të jenë pjesë vitale e sistemit policor të Kosovës.

Sa i përket çështjes së fushatës së bërë në disa komuna të Kosovës, kërkoi të informohet se, sa ka qenë produktive mundësia që të përfshihen në numër më të madh edhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë?

Ministri **Gashi**, gjatë raportimit të sotëm, kam deklaruar se rregullat për shpalljen e konkursit të policisë përcaktohen në bazë të Ligjit për Polici, si kriter kryesor është plotësimi i standardit të kuotës prej 70%. Në periudhën e fundit, një dukuri e veçantë është inkurajimi i gjinisë femërore, me qëllim që të bëhet pjesë e uniformës së Policisë së Kosovës.

Në bazë të kriterëve operative të Departamentit të Policisë, krijohet lista me një numër të madh të aplikuesve, më pas, bëhet radhitja e pikëve, në fund shpallet lista finale, me ç' rast informohen kandidatët, të cilët e kanë kaluar pragun e kalueshmërisë dhe kanë të drejtë të punësohen në Policinë e Kosovës. Radhitja në listë është valide, dy vite, pas kalimit të këtij afati Konkursi përsëritet, me arsye se duhet të testohen zyrtarët policorë, si nga pikëpamja fizike, ashtu edhe ajo intelektuale. Sipas vlerësimeve të para, pjesëmarrja e komuniteteve joshumicë është e kënaqshme.

Kemi situata të paraqitjes së rasteve të vjedhjeve, dhe ne gjithnjë bëjmë përpjekje që të zbulohen dhe të parandalohen kur ofrohet mundësia e bashkëpunimit me qytatarët.

Ju them me bindje të plotë se nuk ka hasur në parregullsi në bërjen e klasifikimeve. Ekziston Departamenti Operativ, i cili në mënyrë permanente bën verifikimin e kandidatëve.

**Taibe Canolli- Brajshori**, para ca viteve, kam qenë pjesë e fushatës së vetëdijesimit dhe disa grupe janë trajnuar nga qendrat rajonale të Kosovës. Në kuadër të fushatës, është arritur të rritet inkurajimi dhe vetëdijesimi për mundësinë e aplikimit për punësim në Policinë e Kosovës.

Si problem shqetësues është mungesa e nivelit të arsimimit, sidomos për komunitetin rom.

Aktualisht, në Policinë e Kosovës, janë të punësuar 0.18% nga radha e komuniteteve, ndërsa tani kanë aplikuar 0.19% . Sipas statistikave që posedojmë, ka rënie të përqindjes së aplikantëve të komunitetit rom, ndërsa ka rritje të numri të aplikantëve të komunitetit ashkali dhe komuniteteve tjera, Në ministri, është i punësuar 1 pjesëtar nga komuniteti ashkali, ndërsa 18 janë të uniformuar nga komunitetet tjera dhe janë pjesë e njësisë policore.

**Slobodan Petroviç**, bazuar në informatat e marra nga ministri, lidhur me shpalljen e konkursit policor, mund të vlerësohen se procedurat janë kryer në mënyrë korrekte.

Sa i përket shpalljes së konkursit të policisë për të rinjtë nga radha e komuniteteve, ishte i mendimit se procedurat duhet të jenë më të detajuara, me arsye që të arrijnë kandidatët t'i plotësojnë kriteret që i parasheh konkursi.

Më tej, foli për situatën e sigurisë në Komunën e Graçanicës, ku ai jeton, me konstatim se vjedhjet ndodhin në mënyrë permanente, por kjo dukuri nuk është e përcaktuar në baza etnike, ngase veprime të tilla ndodhin njëjtë edhe për qytetarët tjerë që jetojnë në këtë komunë. Në periudhën e fundit, është rritur numri i policëve, të cilët në mënyrë profesionale i kryejnë aksionet në terren. Këto të arritura janë për t'u falënderuar.

Ajo që më intereson mua dhe shumë qytetarëve tjerë, është rasti i vrasjes së Oliver Ivanoviçit. Këtë pyetje e kam ngritur në Kuvend, si dhe e kam proceduar me shkrim tek ish- ministri, por për arsye të rrethanave, ai është larguar dhe kemi mbetur pa përgjigje. Pra, kanë kaluar gjashtë muaj dhe ende nuk kemi asnjë informatë lidhur me zbardhjen e këtij rasti.

Mbetemi në pritje, që të informohemi, lidhur me hulumtimin e zbardhjes së rastit të Ivanoviçit apo të jepet përgjigjja me shkrim, në një periudhë të caktuar.

**Zoran Mojsiloviç**, me kujdes e kam përcjellë rrjedhën e diskutimit dhe përshtypja ime është se ju insistoni që të ndërtohet besimi në mes të policisë dhe qytetarëve. Ne kemi një problem nga se misioni nuk vepron bindshëm. E them këtë, se neve na ka rrahur policia.

Më intereson fakti se a e keni marrë raportin e Inspektoratit Policor për ngjarjen e cila ka tejkaluar më 24 mars 2018, me ç' rast ka ardhur deri te lëndimi i ministrit, kryetarit të qytetit dhe deputetit. Shkarkimi i këtij rasti ose thirrja në përgjegjësi të personave që kanë ushtruar forcë ndaj zyrtarëve të Kosovës, do të rriste kredibilitetin te populli, sepse fjala jonë në lidhje me institucionet do të zbatohej.

**Kryetari**, kur bëhet fjalë për rastet e vjedhjeve nuk është treguar ndonjë rezultat pozitiv nga ana e policisë. Bindjet e qytetarëve të komunitetit serb, vjedhjet janë të përfshira me rastet e çështjes etnike. Si shembull mori rastin, në fshatin e Bregut të Ri (Novoselë) të banuar me shqiptarë, nuk ndodhin vjedhje të shpeshta, ndërsa në fshatin e banuar me popullatë serbe, incidentet e tilla ndodhin shumë shpesh. Mund të them se rastet e paraqitura nuk identifikohen, për këto arsye komuniteti serb ka humbur besueshmërinë. Sipas informatave që ka, konsideron se statistikak nuk përputhen me gjendjen reale.

Në fund, kryetari parashtroi pyetje për ministrin e cila nuk ndërlihet me temën e caktuar për sot. Mirëpo, ekzistojnë brenga të shumta të pjesëtarëve të komunitetit serb. Një ndër to është rastin kur qytetarët që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës kërkojnë ndihmë sociale, atyre iu kërkohet kopja e letërnjoftimit serb, të cilat në raste të tjera nuk e njohin institucionet e Kosovës. Në bazë të cilit ligj apo vendim praktikohet kjo dukuri. Ky është një paradoks. Në qoftë se kjo praktike vlen për të gjithë qytetarët, atëherë unë tërhiqem nga kjo pyetje, por nëse praktikohet vetëm për përfaqësuesit serbë, kjo nuk është në rregull.

**Ministri Gashi**, në përgjigjen e pyetjeve, tha se është arritur shkalla e zbulimit deri në 70 %, që do të thotë se në rajon jemi model. Por, kanë ndikim deklaratat e rreme të lajmeve, rrjetet sociale, të cilat ndikojnë në jostabilitetin e shtetit tonë.

Jemi interesuar të ketë përfaqësim shumetnik në nivel të Kosovës, me qëllim që secili zyrtar me uniformë të punojë në njësinë e caktuar. Në të ardhmen, planifikohet të ketë strategji për fuqizimin e departamentit, i cili në formë të drejtpërdrejtë do të merret me zyrtarë policorë që i përkasin komuniteteve.

Në fund të këtij muaji, zgjidhet drejtori dhe më pas do të bëhen disa lëvizje në favor të rritjes së nivelit të përgjegjësi në sistemin operativ.

Ju sigurojë se brenda mundësive që kemi, do të punojmë me efikasitet që të zbardhen rastet, të cilat dëmtojnë pronën, pasurinë dhe cenojnë integritetin e qytetarëve. Në këtë mënyrë do të rritet besueshmëria në raport të bashkëpunimit me qytetarët, të cilët do të paraqesin rastin.

Ajo çka u diskutua gjatë takimit të sotëm, bazuar në kërkesat dhe shqetësimet e paraqitura nga anëtarët e komisionit, do të shqyrtohet bashkërisht me juve, me qëllim që të arrihen ndryshimet e nevojshme.

**Kryetari**, për arsye të mungesës së kuorumit, propozoi që pikat 3, 4 dhe 5, të shtyhen për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:30.*

*Përgatitur nga:*

*Njësia mbështetëse e komisionit.*

**Kryetari i komisionit,  
Igor Simiq**